



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 342, datë 24.09.2020

PËR
PËRFSHIRJEN E KANDIDATES, ZNJ. {...}NË PROCEDURAT E KOMANDIMIT SI
NDIHMËSMAGJISTRATE PRANË GJYKATËS SË LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë bazuar në Vendimin nr. 258, datë 23.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren {...}e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR